



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEQA"

SYLLABUS i Lëndës Sjellja Organizative

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Biznesit
Titulli i lëndës:	Sjellja Organizative
Niveli:	BSc.
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	III (semester VI)
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	FB
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	Përshkruani lëndën: Sjellja organizative është një ndër lëndët bazë të formimit të personit që do të punojë në pozicione drejtuese nga më të thjeshtat e deri tek me të lartat, në fushën e prodhimit, apo shërbimeve , në fushën e financave etj, si në sektorin privat ashtu dhe në atë publik. Kjo realizohet përmes shpjegimit të faktorëve të sjelljes si vlerat,qëndrimet,personaliteti,përceptimi,si dhe të organizatës si përdorimi i pushtetit,komunikimi,organizimi i punës etj me qëllim motivimin e punonjësve për një produktivitet më të lartë dhe kënaqësi maksimale.
Qëllimet e lëndës:	T'i pajisë studentët me njohuritë bazë të nevojshme për të kuptuar sjelljen e punonjësve vartës, apo bashkëpunorëve për të parashikuar, shpjeguar dhe kontrolluar me qëllim arritjen së efektivitetit maksimal nga përdorimi i burimeve njerëzore në dispozicion të organizatës. • Të analizojë në mënyrë të detajuar faktorët që ndikojnë në sjelljen e njeriut me qëllim që vendimet manaxheriale të jenë me një nivel të lartë të efektivitetit. • Te aftësojë studentin që njohuritë e fituara gjatë këtij kursi t'i përdorë në funksion të formimit të tij dhe njëkohësisht të orientohet

	me sukses në biznes. • Zhvillimi i këtij moduli është përfitimi i njohurive të nevojshme të avansuara në lëmin e sjelljeve 2 organizative. • Sjellja organizative, shtjellon si në aspektin teorik ashtu edhe në atë praktik, njohuritë e përgjithshme mbi sistemin sjelljeve organizative dhe teoritë organizative.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	• Të pajisen me njohuri bazë të sjelljes organizative, ku këto njohuri do t'i aplikojnë gjatë punës së tyre në veprimtarit prodhuese, shërbyese apo në veprimtarinë e financave, etj. • Të aftësojë studentin që njohuritë e fituara gjatë këtij kursi t'i përdorë në funksion të formimit të tij dhe njëkohësisht të orientohet me sukses në biznes; • Kjo realizohet përmes shpjegimit të faktorëve të sjelles si vlerat, qëndrimet, personaliteti, përceptimi, përdorimi i pushtetit, komunikimi, organizimi i punës, etj me qëllim të motivimit të punonjësve për një produktivitet më të lartë dhe kënaqësi maksimale, etj.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënës të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	2	2
Ushtrime në teren	1`	3	3
Kollokfiume, seminare	1	5	5
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgatitja përfundimtare për provim	5	4	20
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	5	5
Totali			125
Metodologjia e mësimdhënies:	Mësimdhënia do të zhvillohet përmes ligjëratës, raste studimi, interpretimeve individuale e grupore, punimit të seminareve, vetëvlerësimeve periodike, etj. Të gjitha këto do të realizohen në aspektin		

	teorik dhe praktik duke i prezantuar materialet në formën audiovizuale përmes teknologjisë elektronike me programet e Windows Office. Në aspektin teorik do të ofrohen njohuri të përgjithshme shkencore, bazuar në literaturën. Pjesa praktike kryesisht do të realizohet përmes shembujve konkret nga literatura dhe nga njohuritë praktike të ndërmarrjet prodhuese private e publike dhe të organizatat jofitim prurëse. Në këtë mënyrë do të synohet krijimi i raporteve ndërevepruese profesor-student si dhe ai student-student. bashkëkohore. Moduli do të bazohet në ligjërata interaktive dhe në punë grupore të studentëve. Në çdo ligjëratë do të prezentohen konceptet dhe teknikat kyçe në aspektin e menaxhimit të sjelljeve organizative. Ndërsa në orë të ushtrimeve përmes rasteve studimore nga sjellja organizative studentët do të inkurjohen në aplikimin e këtyre koncepteve dhe teknikave në zgjidhjen e problemeve që ndërlidhën me sjelljet organizative.
Mësimi aids/ IT	Prezantimi i temës mësimore në Power Point, Raste të studimit punimit të seminareve, vetëvlerësimeve periodike, etj
Raporti:	Raporti ndërmjet të pjesës teorike dhe praktike: 60:40
Metodat e vlerësimit:	Metoda e vlerësimit: Testi i parë 40% Testi i dytë 40% Pjesmarria në ligjërata dhe ushtrime,..... 10% Punime seminarike,10%
Literatura	
Literatura bazë:	1. Prof. Assoc. Dr. Mimoza Manxhari, Sjellja në Organizatë, Tiranë, 2013
Literatura shtesë:	2. Organisaconal Behavior; Menaxhmenti kreativ& Lidership; Management Fundamentals (Concepts, Applications, Skill Development) autor: Robert N. Lussier publikoj: Thomson South Western 2006 USA - M.Kasimati, M.Manxhari; Sjellje Organizative, Tirane, 2005
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Sjelljet në organizatë dhe kuptimi i sjelljes organizative
Java e dytë:	Zhvillimi historik i sjelljes organizative
Java e tretë:	Etika përgjegjësia shoqërore dhe sjellja njerëzore në organizatë
Java e katërt:	Diversiteti dhe ndryshimet individuale
Java e pestë:	Përceptimi

Java e gjashtë:	Ndryshimet e personalitetit mes individëve
Java e shtatë:	Qëndrimet
Java e tetë:	Testi i parë
Java e nëntë:	Vlerat personale, kultura, klima e organizatës
Java e dhjetë:	Motivimi
Java e njëmbëdhjetë:	Format dhe zhvillimi i grupeve
Java e dymbëdhjetë:	Komunikimi
Java e trembëdhjetë:	Negocimi
Java e katërbëdhjetë:	Udhëheqja
Java e pesëmbëdhjetë:	Testi i dytë

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
Cakto politikat e mirësjelljes konform statusit të UHZ-së.